



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike*  
*(MEPTINIS)*

*Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja*  
*(MEZTIPSU)*

*Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investment*  
*(MEETIESI)*



Agjencia Kosovare e Standardizimit  
Kosovo Standardisation Agency  
Kosovska Agencija za Standardizaciju

**RREGULLORE E BRENDSHME NR. 02/2020 PËR RREGULLAT DHE  
PROCEDURAT PËR HARTIMIN, NJOHJEN, ADOPTIMIN, MIRATIMIN DHE  
PUBLIKIMIN E STANDARDEVE EVROPIANE SI STANDARDE KOSOVARE**

Në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i Ligjit Nr. 06/L-019 për Standardizim; Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit; Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2018 për Logon e AKS; Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2018 për Komitete Teknike; dhe Marrëveshjet Licencë ndërmjet AKS dhe Organizatave Evropiane të Standardizimit (CEN dhe CENELEC).

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Kjo rregullore e brendshme, përcakton rregullat dhe procedurat për miratimin e standardeve kosovare, evropiane dhe ndërkombëtare që janë relevante për Kosovën.
2. Kjo rregullore e brendshme përcakton rregullat dhe procedurat për standardizimin e kryer nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS).

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

1. AKS adopton standardet evropiane të zhvilluara nga Organizatat Evropiane të Standardizimit CEN dhe CENELEC për zbatim në Kosovë. Ndërsa, kur nënshkruhen marrëveshje tjera me Organizatat Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO dhe IEC), atëherë mund të jenë të nevojshme dispozita të reja që pasqyrojnë miratimin kombëtar të standardeve ISO/IEC, megjithatë parimet për zhvillimin dhe miratimin e standardeve do të mbeten të pandryshuara.
2. Ajo përfshin hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane dhe kombëtare të Kosovës për përdorim në Kosovë së bashku me rishikimin, amendimin, shfuqizimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

## **Neni 3**

### **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij dokumenti, përkufizimet e dhëna në Ligjin Nr. 06/L-019 për Standardizim; Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit; Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2018 për Logon e AKS; Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2018 për Komitete Teknike; Marrëveshjet Licencë ndërmjet AKS dhe Organizatave Evropiane të Standardizimit (CEN dhe CENELEC) për miratimin e standardeve evropiane "homegrown" dhe Udhëzuesi ISO/IEC 2:2009, zbatohen si në vijim.

#### **1.1. Trupi Teknik**

Organi përgjegjës për një fushë të caktuar të punës së standardeve, zakonisht komiteti teknik, këshilli profesional i standardizimit, etj.

#### **1.2. Draft pune**

Hartimi i dokumentit për shqyrtim nga komiteti teknik.

#### **1.3. Projekt pune**

Një projekt standard që pritet të bëhet standard, ose një rishikim/ndryshim i një standardi.

#### **1.4. Paketa (grup) e standardeve**

Një grup i standardeve (zakonisht bazohen në standardet e pranuar të EN, që janë zhvilluar përmes një procesi të ndërtimit të konsensusit) që zhvillohen njëkohësisht.

#### **1.5. Konsensusi**

Marrëveshje e përgjithshme, që karakterizohet nga mungesa e kundërshtimit të qëndrueshëm ndaj çështjeve thelbësore dhe nga një proces që merr parasysh pikëpamjet e të gjitha palëve të interesit dhe për tu pajtuar në çdo argument konfliktual (Udhëzuesi ISO/IEC 2:2009).

Shënim: Konsensusi nuk duhet të nënkuptojë unanimitet.

#### **1.6. Shtojca kombëtare**

Teksti informativ shtesë që mbështet zbatimin kombëtar të një standardi evropian.

#### **1.7. Kushtet e veçanta kombëtare**

Karakteristika kombëtare ose praktika që nuk mund të ndryshohet për një periudhe të gjatë, p.sh. kushtet klimatike, kushtet e tokëzimit elektrik.

#### **1.8. Devijimi-A**

Devijimi kombëtar për shkak të rregulloreve, ndryshimi i të cilave për momentin është jashtë kompetencës së AKS.

#### **1.9. Emërtimi kombëtar**

Identifikimi kombëtar i një anëtari (NSB), jo domosdo identik me akronimin e tij, i shtuar si prefiks i emërtimit evropian në të gjitha faqet e zbatimit kombëtar të një publikimi. Për Standardet Kosovare, emërtimi kombëtar është "SK".

Shënim: Shih rregulloret e brendshme CEN/CENELEC, Pjesa 3, Shtojca ZC.2.

#### **1.10. Identifikimi kombëtar**

Akronim, shkurtim ose emri i një anëtari, i cili është shtuar si identifikim kombëtar në të gjitha faqet e ndonjë publikimi.

#### **1.11. Zbatimi kombëtar**

Procesi i dhënies së statusit të publikimit CEN/CENELEC në një publikim kombëtar identik në përmbajtjen teknike dhe paraqitjen (përveç përkthimit) ose me publikimin e një teksti të njëjtë ose me anë të miratimit, siç përcaktohet në Pjesën 2 të Rregullores së Brendshme CEN/CENELEC.

### **Neni 4**

#### **Procesi i standardizimit**

##### **1. Të përgjithshme**

Përmes aktiviteteve të saj, AKS është përgjegjëse për lëshimin e standardeve kosovare dhe dokumenteve të standardizimit.

1.1. Të gjitha vendimet që lidhen me zhvillimin e një standardi kosovar merren nga trupi teknik i AKS (zakonisht një Komitet Teknik), përveç në fazat e mëposhtme nga:

1.1.1. Këshilli Profesional i Standardizimit në miratimin e një artikulli të punës;

1.1.2. Publiku i gjerë dhe të gjithë akterët në fazën e diskutimit publik;

1.1.3. Menaxhmenti i AKS, si një standard i miratuar.

2. Procesi i standardizimit i aplikuar në kuadër të AKS synon të sigurojë që standardet e miratuara kosovare janë relevante për nevojat e palëve të interesit të Kosovës.

3. Procesi i standardizimit përfshin 3 akterë kryesorë të lidhur me AKS:

- 3.1. Këshilli Profesional për Standardizim, i cili është përgjegjës për miratimin e programeve të punës, përbërjen dhe udhëheqjen e Komiteteve Teknike që veprojnë sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit;
- 3.2. Komitetet Teknike të AKS të cilët janë përgjegjëse për hartimin e programeve të punës dhe standardizimit brenda fushëveprimit të tyre dhe veprojnë sipas Udhëzimit Administrativ nr. 16/2018 për Komitete Teknike;
- 3.3. Stafit dhe menaxhmenti i AKS, të cilët janë përgjegjës për të siguruar punën dhe përgjegjësitë e AKS në procesin e standardizimit.

Përveç kësaj, praktika e standardizimit kërkon që palët e interesit që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në proces, të kenë mundësinë të paraqesin pikëpamjet e tyre mbi standardet e propozuara. Kjo realizohet përmes një procesi të "diskutimit publik".

#### 4. Konsensusi

Vendimet duhet të merren në bazë të parimit të konsensusit duke marrë parasysh baraspeshën e interesave nga palët e interesit. Palët e interesit të përfshira në këtë proces duhet të angazhohen për avancimin e standardizimit në interesin e gjerë të Kosovës dhe nuk duhet të përpiqen të pengojnë procesin e standardizimit.

Kryetari dhe sekretari i komiteteve teknike duhet të sigurojnë që proceset e vendimmarrjes të bazohen në zbatimin e parimeve të konsensusit. Kur një anëtar mbështet një kundërshtim themelor brenda afatit të caktuar dhe e mbështet atë me argumente të forta, këto shqetësime do të merren seriozisht. Në rast se konsensusi nuk mund të konsiderohet se është arritur, kryetari dhe sekretari duhet të këshillojnë menaxhmentin e AKS, i cili do të iniciojë një proces për zgjidhjen e konsensusit.


#### 5. Procedura për zhvillimin dhe miratimin e standardeve kosovare

Zhvillimi i standardit është një projekt, fazat kryesore të të cilit dhe dokumentet shoqëruese janë paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela 1. Fazat e projektit dhe dokumentet shoqëruese dhe afatet kohore**

Faza e Projektit	Dokumenti i asociuar		Afati kohor indikativ
Propozimi dhe pranimi i një detyre të re	Programi i Punës		30 ditë
Hartimi	Drafti i Punës	DP	
Diskutime publike	Diskutim publik i draftit	Draft SK	60 ditë
Shqyrtimi i komenteve			30 ditë
Miratimi i draftit	Drafti final i Standardit Kosovar	DF SK	
Përgatitja për miratim dhe publikim			
Miratimi			
Publikimi	Standardi Kosovar	SK	
Mirëmbajtja dhe shqyrtimi/shfuqizimi			

**Tabela 2. Fazat e zhvillimit, publikimit dhe mirëmbajtjes së standardeve**



Për të lejuar miratimin efikas të standardeve, procesi i miratimit, standardet evropiane të lidhura dhe dokumentet tjera referuese mund t'i nënshtrohen procesit të standardeve së bashku si një "paketë".

Për zhvillimin e standardeve kosovare, standardet evropiane sipas marrëveshjeve licencë me CEN/CENELEC ose dokumente tjera referuese (duke përfshirë ndryshimet dhe rishikimet) duhet të zbatohen procedurat e mëposhtme:

## **6. Faza e propozimit**

1. Qëllimi i kësaj faze është të merret një vendim për shtimin e një pike të re të punës në programin e punës së një komiteti teknik. Propozimet mund të vijnë nga çdo palë e interesit. Ato merren në shqyrtim nga organi përkatës teknik, i cili mund të jetë ose një komitet teknik ekzistues ose një organ i krijuar për këtë qëllim nën mbikëqyrjen e KPS. Kur të arrihet konsensusi, komiteti teknik shton projektin e ri të punës në programin e tij të punës, në pajtim me miratimin e KPS.

2. Nëse projekti i punës bie jashtë fushëveprimit të një Komiteti Teknik ekzistues, KPS mund të vendosë të:

2.1. Shton atë në programin e punës së një komiteti me interesa të ngjashme, fushëveprimi i të cilit do të zgjerohet për ta përfshirë atë,

2.2. Krijon një komitet teknik për të mbuluar fushëveprimin e punës,

2.3. Krijon një grup pune për të zhvilluar standardin.

Shënim: Këshilli Profesional i Standardizimit, miraton programet e punës të komiteteve teknike.

3. Kjo fazë përfundon me shtimin e një projekti të punës në programin e standardizimit të AKS.

4. Kur standardi bazohet në një standard evropian që do të miratohet sipas një marrëveshje licencë me CEN ose CENELEC, AKS do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të marrë tekstin e standardit nga CEN/CENELEC Management Centre.

## **7. Faza përgatitore**

7.1. Faza përgatitore është faza e përgatitjes së draftit të punës (DP KS). Sapo të miratohet projekti i ri i punës, emërohet një udhëheqës projekti nga trupi teknik për të udhëhequr përgatitjen e një drafti. Faza përgatitore tejkalohet kur projekti i punës bazohet në një standard evropian ose dokument referimi që do të miratohet pa ndryshime ose pa kushte kombëtare. Në raste të tilla dokumenti referues bëhet projekt i punës.

7.2. Kjo fazë përfundon kur udhëheqësi i projektit konsideron se drafti i punës ka përfunduar dhe e dërgon atë tek sekretari i KT.

## **8. Faza e komitetit teknik**

1. Qëllimi i kësaj faze është të sigurojë që komiteti teknik përgjegjës konsideron se drafti i punës ose dokumenti referent ka përfunduar dhe mund të shpërndahet për komente më të gjera në diskutim publik. Drafti i punës shpërndahet për të gjithë anëtarët e komitetit teknik për shqyrtim.

2. Gjatë kësaj faze, KT me ndihmën e sekretarit përkatës:

2.1. identifikon standardet kontradiktore që ka të ngjarë të tërhiqen në publikimin e standardit. Për standardet evropiane, ky informacion zakonisht do të përfshihet në vetë standardin evropian.

2.2. identifikon informacionin në lidhje me kontekstin e standardit dhe zbatimin e tij që mund të jetë e nevojshme për bazën në Parathëniet Kombëtare dhe Shtojca aty ku është e aplikueshme.

3. Projekti i vendosur në konsultim publik i Standardeve Evropiane do të shoqërohet me informata lidhur me Parathëniet Kombëtare dhe shtojcat nëse ato janë për tu përfshirë në procesin e konsultimit për të mbuluar kushtet kombëtare sipas rastit (shih A.6).

4. Faza përfundon kur arrihet konsensus në komitetin teknik se drafti i punës është i gatshëm t'i nënshtrohet diskutimit publik dhe drafti i përcillet brenda AKS për diskutim publik.

## **9. Faza e diskutimit publik**

1. Qëllimi i kësaj faze është t'i mundëson palëve më të gjera që të komentojnë draftin dhe pranueshmërinë e tij si një standard kosovar. Diskutimet publike janë konsultime formale që kryhen nga AKS mbi draft standardet. Një listë e draft standardeve për konsultime publike, publikohet me afate për dorëzimin e komenteve. Gjatë një diskutimi publik 60 ditor, drafti është në dispozicion sipas kërkesës së AKS dhe i njëjti mund t'u ofrohet organeve të huaja kombëtare të standardeve sipas kërkesës.

2. AKS do të informojë anëtarët e komitetit teknik dhe çdo pale të interesit që janë identifikuar, për fillimin e diskutimeve publike, veçanërisht kur projektet e punës kanë të bëjnë me legjislacion, AKS do të informojë autoritetet publike përgjegjëse për legjislacionin përkatës. Komentet mund të dorëzohen në email adresën e AKS. Sekretari i komitetit teknik është përgjegjës për mbledhjen e të gjitha komenteve të pranuar, duke përfshirë edhe ato nga organet e huaja të standardeve kombëtare në përgjigje të procedurave me qëllim të notifikimit.

3. Pas përfundimit të diskutimit publik, komentet e pranuar përcillen në komitetin teknik. Procesi i diskutimit publik zbatohet për të gjitha draftet e standardeve kosovare nga çfarëdo burimi. Në raste të jashtëzakonshme, kur një standard kërkohet urgjentisht

dhe dokumenti i referencës tashmë i është nënshtruar një procesi të ndërtimit të konsensusit (p.sh. një standard ekzistues), faza e diskutimit publik mund të kryhet në një afat të shkurtuar (të shpejtë).

4. Faza e diskutimit publik përfundon, kur komiteti teknik është njoftuar për komentet e marra.

## **10. Faza e miratimit**

1. Qëllimi i kësaj faze është të konfirmojë nëse rezultatet e diskutimit publik tregojnë se drafti është i pranueshëm për t'u bërë një standard kosovar. Nëse nuk ka komente, ose nëse vetëm komentet editoriale janë marrë gjatë diskutimit publik, komiteti teknik pritet të miratojë projektin që do të zhvillohet drejtpërdrejt në një draft standard final (DF SK).

2. Komiteti Teknik duhet të shqyrtojë komentet e pranuar. Palët e interesit të cilët kanë komentuar dhe nuk janë anëtarë të komitetit teknik ftohen të marrin pjesë në takimin e duhur të komitetit teknik. Nuk është e përshtatshme që të bëhen ndryshime të mëdha në këtë fazë përveçse si rezultat i komenteve të publikut.

3. Komiteti Teknik vendos me konsensus mbi zgjidhjen e të gjitha komenteve për ndryshimin e draft standardit sipas rastit dhe vendos zyrtarisht nëse do të vazhdojë me miratimin e standardit.

4. Drafti final që rrjedh nga ky takim miratohet nga komiteti teknik si një draft standard përfundimtar (DF SK).

## **11. Faza e adoptimit**

1. Draft-standardi final përgatitet për publikim. Nëse nuk është përgatitur akoma, Parathënia Kombëtare dhe Shtojcat, kompletohen së bashku me “cover page” (shih shtojcën A).

1.1. Zyrtari përgjegjës i AKS:

1.1.1. Kontrollon nëse standardet kontradiktore duhet të tërhiqen;

1.1.2. Kryen një kontroll të cilësisë në draftin final të standardit;

1.1.3. Verifikon që një diskutim publik ka ndodhur dhe se komentet janë zgjidhur;

1.1.4. Verifikon që komiteti teknik mori një vendim për të publikuar.

2. Pas përfundimit të këtij procesi, një dokument në emër të AKS që zyrtarisht pranon publikimin e standardit nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili autorizon botimin e standardit dhe tërheqjen e standardeve në kundërshtim (shih 3.3.2).



## **12. Faza e publikimit**

1. AKS përgatit standardin e adoptuar si një standard të ri kosovar (SK), dhe pas nënshkrimit të vendimit për miratim të standardit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKS, standardi publikohet në ueb faqe. Nëse është një standard evropian i miratuar sipas marrëveshjeve të licencimit informohet CEN/CENELEC.

2. Rregullimet dhe ndryshimet

1.1. Gabimet e paraqitura pa dashje gjatë hartimit ose miratimit të një standardi që mund të çojnë në aplikimin e pasaktë ose të pasigurt të standardit, mund të rregullohet me botimin e një korrigjimi.

1.2. Aty ku standardet bazohen në standardet evropiane ose dokumentet e tjera referuese, standardi duhet të mbahet i azhurnuar duke miratuar ndryshime, korrigjime dhe rishikime sipas rastit. Aty ku standardet harmonizohen me standardet evropiane, procesi i rishikimit duhet të marrë në konsideratë nëse standardi i rishikuar është miratuar zyrtarisht nga Bashkimi Evropian si dhe nga CEN/CENELEC.

1.3. Ndryshimet (përveç korrigjimeve të thjeshta) në tekstin e një standardi kosovar i nënshtrohen të njëjtave procedura si teksti origjinal.

## **13. Faza e rishikimit**

1. Rishikimet mund të bëhen në çdo kohë për të reflektuar ndryshimet gjatë zbatimit të tij. Rishikimi zakonisht përmban:

1.1. Konfirmimin e standardit për përdorim të vazhdueshëm;

1.2. Amendamentimin për të pasqyruar evoluimin e praktikave; ose

1.3. Shfuqizimin.

2. Nëse nuk bëhet asnjë rishikim, komiteti teknik duhet të bëjë një rishikim të paktën çdo 5 vjet, për të përcaktuar nëse standardi ende plotëson nevojat e palëve të interesit.

## **14. Shfuqizimi**

1. Një standard kosovar shfuqizohet:

1.1 nëse standardi kosovar është në kundërshtim me standardin evropian;

1.2 pas një procesi rishikimi;

1.3 me vendim të komitetit teknik se standardi nuk është më në fuqi;

1.4 me vendim të AKS pas informacionit nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit se standardi nuk është më në fuqi.

2. Nëse standardet duhet të shfuqizohen sipas paragrafit 1.3 ose 1.4, AKS publikon njoftimin për shfuqizim të standardit në ueb faqe me qëllim që të informojë palët e interesit. Prosesi i shfuqizimit formalizohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të AKS në të njëjtën mënyrë si miratimi i standardeve.

3. Standardet e shfuqizuara arkivohen dhe mbahen nga AKS. Ato mund të vazhdojnë të shiten, por standardet e shitura duhet të shënohen qartë (ose vulosur) për të sqaruar statusin e tyre si "standard i shfuqizuar". AKS nuk merr përgjegjësi për përmbajtjen e standardeve të shfuqizuara.

## **Shtojca A**

### **Adoptimi dhe Publikimi i Standardeve Evropiane si Standarde Kosovare**

#### **A.1 Fushëveprimi**

Kjo shtojcë përcakton procesin për publikimin e Standardeve Evropiane si Standarde Kosovare duke përfshirë përgatitjen e "cover page" dhe parathëniet kombëtare për adoptimin e standardeve evropiane si standarde kosovare sipas marrëveshjeve licencë me CEN/CENELEC.

Shtojca përcakton formatin dhe përmbajtjen e domosdoshme për AKS për të përmbushur detyrimet e marrëveshjes licencë. Kjo përfshin rregullat siç përcaktohen në rregullat e brendshme CEN/CENELEC pjesa 3 dhe Udhëzuesi CEN/CENELEC 10.

Parathënia përmban informata që AKS është e detyruar të ofrojë. Mund të përmbajë informacion shtesë për të plotësuar nevojat e organit kombëtar të standardizimit ose të industrisë së Kosovës.

Shtojca gjithashtu përcakton përdorimin e Shtojcave Kombëtare në standardet evropiane dhe ofron shembuj të llojeve të informacionit që mund të përfshihen.

#### **A.2 Bazat për adoptim**

Standardet Evropiane do të adoptohen si Standarde Kosovare në përputhje me dispozitat e mëposhtme bazuar në:

- Rregulloret e brendshme CEN/CENELEC Pjesa 3: Rregullat për strukturën dhe hartimin e publikimeve CEN/CENELEC (Udhëzuesi ISO/IEC-Pjesa 2, 2016 të modifikuara) 2017;
- Udhëzuesi CEN/CENELEC 10: Politika për shpërndarjen, shitjen dhe të drejtën e autorit të publikimeve të CEN/CENELEC Botimi 4, 2017-11;
- Marrëveshjet Licencë me CEN/CENELEC për adoptimin e standardeve evropiane në Kosovë.
- Rregullore e brendshme 03/2020 për Marrëveshjet Licencë ndërmjet AKS dhe Organizatave Evropiane të Standardizimit (CEN/CENELEC) për adoptimin e standardeve evropiane "homegrown".

#### **A.3 Adoptimi i standardeve EN**

A.3.1. Sipas kushteve të marrëveshjeve licencë me CEN/CENELEC, AKS mund të adopton standardet "homegrown" EN me ose pa modifikime.

A.3.2. Në parim AKS do të adopton standardet EN pa modifikime. Përfundimisht aty ku ka justifikime të mjaftueshme, një standard mund të miratohet me modifikime që i përshtaten nevojave të Kosovës.

A.3.3. Teksti i ratifikuar në gjuhën angleze i ofruar nga CCMC përdoret si tekst i standardit evropian për adoptim.

A.3.4. Standardet Kosovare që adoptohen nga Standardet Evropiane duhet të kenë numrin dhe datën e standardit evropian si pjesë e referencës. "cover page" duhet të jetë si në pikën A.8.

#### **A.4 Ndryshimet në standardet evropiane**

Në raste të veçanta kur propozohet të adoptohen standardet evropiane me modifikime, menaxhmenti i AKS duhet të informohet në fazat e hershme të miratimit. Arsyetimet për modifikime të tilla mund të përfshijnë "kushte të veçanta kombëtare" në lidhje me kushtet ose praktikatat që nuk mund të ndryshohen në Kosovë.

Aty ku standardet kosovare adoptojnë standardet e harmonizuara të BE, që nuk janë plotësisht të zbatueshme në praktikë me dispozitat e legjislacionit të BE, mund të bëhen devijime në standarde për të pasqyruar kushtet në Kosovë. Kur ndryshime të tilla janë të nevojshme, ato nuk duhet të paraqesin barriera që pengojnë tregtinë e produkteve që plotësojnë dispozitat e pa modifikuara të standardeve evropiane.

Menaxhmenti i AKS do të konsultohet me CCMC siç kërkohet në marrëveshjet licencë.

#### **A.5 Publikimi i standardeve evropiane**

Standardet Evropiane të publikuara në Kosovë duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Shtojcës ZC të Rregullores së Brendshme CEN/CENELEC Pjesa 3: 2017 (E) e ndryshuar më poshtë duke pasqyruar marrëveshjet licencë me CEN/CENELEC.

Standardi evropian si rregull do të zbatohet në Kosovë me anë të metodës së riprodhimit (nganjëherë referuar si "cover page").

Faqja e titullit kombëtar shtohet (shih Figurat A.1 dhe A.8).

Faqja e titullit kombëtar duhet të përmbajë tekstin e mëposhtëm, duke treguar marrëdhënien me standardin evropian që zbaton. Ky Standard Kosovar SK EN 1234: data<sup>1</sup> është zbatimi identik i EN 1234:data<sup>2</sup> dhe është i adoptuar sipas marrëveshjes licencë me CEN/CENELEC, Rue de la Science 23, B-1040 Brussels Belgium.

Parathënie dhe shtojca kombëtare mund të përfshihen në mënyrë të tillë që nëse ato shikëputen, standardi evropian nga faqja e titullit në faqen e fundit të tekstit (duke përfshirë edhe anekset nëse ka) mbetet i paprekur. Identifikuesi kombëtar duhet të bëhet i dukshëm në çdo faqe të zbatimit kombëtar, duke ruajtur elementet e tekstit përfundimtar të EN siç parashikohet nga CCMC.


---

<sup>1</sup> Viti i publikimit në Kosovë

<sup>2</sup> Data e disponueshmërisë nga CEN/CENELEC

Një përbërje tipike e një standardi evropian kur publikohet si një standard kosovar është paraqitur në figurën A.1.

- a. Faqja e titullit
- b. Parathënia kombëtare
- c. Shtojca kombëtare
- d. Faqja e titullit të EN
- e. Teksti i EN
- f. EN Shtojca



Elementet kombëtare (lartë) - Elementet evropiane (poshtë)

Figura A.1 - Elementet e publikimit kombëtar të një standardi evropian

## **A.6 Informacione Shtese Kombëtare**

### **A.6.1 Të përgjithshme**

Adoptimet e standardeve evropiane në Kosovë, mund të përfshijnë një parathënie kombëtare për të ofruar këshilla dhe udhëzime për zbatimin e standardit në Kosovë. Këshilla dhe udhëzime të mëtejshme mund të jepen në një shtojcë kombëtare. Në disa raste (p.sh. Eurokodet) shtojcat kombëtare që përmbajnë parametra dhe dispozita të përcaktuara në nivel kombëtar janë parashikuar në hartimin e standardeve evropiane. Parathëniet kombëtare dhe shtojcat kombëtare janë gjithmonë informative në status. Nevoja për këshilla dhe udhëzime që duhet të përfshihen në Parathënie dhe Shtojca Kombëtare duhet të identifikohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe para lëshimit të draft standardit në konsultim publik.

### **A.6.2 Parathëniet kombëtare**

Për të dalluar parathënien e një standardi evropian nga një kombëtar, ky i fundit do të drejtohet "Parathënie kombëtare". Fjala "kombëtare" gjithashtu do të shtohet në çdo informacion të mëtejshëm të shtesës kombëtare.

Një parathënie kombëtare mund të përfshijë elementet e mëposhtme:

- a) Një identifikues kombëtar;
- b) Detajet e standardeve të shfuqizuara dhe marrëdhëniet me dokumentet e tjera të publikuara;
- c) Trupi teknik përgjegjës për standardin;
- d) Referenca për ndonjë ndryshim të përfshirë dhe një shpjegim të shënimeve.

### **A.6.3 Shtojcat kombëtare**

Shtojcat kombëtare, nëse ka, do të vendosen para ose pas tekstit të plotë të një standardi evropian (duke përfshirë shtojcat e EN). Ato përmbajnë vetëm informacionin e dhënë për zbatim më të lehtë. Shtojca kombëtare nuk do të ndryshojë asnjë dispozitë të standardit evropian. Nëse përfshihen shtojcat kombëtare, duhet siguruar që me emërtimin e tyre të dallohen qartë nga çdo shtojcë tjetër në standard. Prandaj ata do të emërtohen NA, NB, etj.

## **A.7 Notifikimi i miratimit të standardeve kosovare**

AKS do të notifikojë CCMC për standardet evropiane të adoptuara sipas kushteve të marrëveshjeve licencë duke dërguar një kopje të standardit përkatës kosovar në Drejtorinë e Perspektivës së Tregut dhe Inovacionit të regjistruar në CEN/CENELEC ose një kopje elektronike në email adresën: [ENadoptions@cenelec.eu](mailto:ENadoptions@cenelec.eu)


**A.8 Fleta e përparme (“cover page”)**

Standard Kosovar	Titulli i standardit	SK EN 1234:20XX
Ky Standard Kosovar SK EN 1234:20XX është zbatimi i njëjtë i EN 1234:XXXX dhe miratohet me marrëveshjet licencë me CEN/CENELEC, Rue de la Science 23, B-1040 Brussels Belgium		

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore e brendshme hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKS.

Hafiz Gara

  
\_\_\_\_\_  
Drejtori i Përgjithshëm i AKS

Prishtinë,  
20.03.2020